

**Vendim nr. 234 datë 16.10.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare  
Marjana Semini, Anëtare

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** SINAN GJONI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 204, datë 15.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr. 1464, datë 11.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1051, datë 19.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.  
Kthimi i çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për zhvillimin e gjykimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 27, 28, 42 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 32 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## I

### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Sinan Gjoni (në cilësinë e paditësit të kundërpaditur në procesin gjyqësor objekt të ankimit kushtetues), në bazë të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” (*ligji nr.7501/1991*), ka përfituar tokë arë, të cilën e ka regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Krujë (*ZVRPP*) dhe është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë me nr.15/1, ZK 1299, me sipërfaqe 3112 m<sup>2</sup> tokë arë dhe për pasurinë me nr.8/5, ZK 1299, me sipërfaqe 3500 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Budull-Krujë.

2. Duke pretenduar se këto dy prona ishin zënë në mënyrë të padrejtë nga shtetasi Xh.Gj. (i padituri/kundërpaditës në procesin gjyqësor) dhe të paditurit A.Gj., G.Gj. dhe S.Gj., i është drejtuar gjykatës me padi për lirim dhe dorëzimin e kësaj sipërfaqeje dhe pagimin e detyrimit për përdorimin me keqbesim të asaj toke. Ai ka pretenduar se deklaratat, sipas të cilave rezulton se pronat e sipërcituara ai ia ka shitur shtetasit Xh.Gj., nuk janë firmosur prej tij dhe, për më tepër, ai nuk kishte të drejtë të shiste dhe pjesën që i takonte pjesëtarëve të tjerë të familjes, pasi ajo tokë ishte fituar me ligjin nr. 7501/1991.

3. I padituri/kundërpaditës Xh.Gj., ka pretenduar se sipërfaqen prej 2700 m<sup>2</sup>, të ndodhur në pasurinë me nr. 8/5, KZ 1299 ia ka blerë kërkuesit Sinan Gjoni, sipas deklaratës së datës 06.01.1999 të firmosur prej këtij të fundit dhe bashkëshortes së tij kundrejt shpërblimit, fakt i provuar si nga akti i ekspertimit grafik të nënshkrimeve të dy bashkëshortëve, ashtu edhe nga aktshitja dhe deklarata e datës 01.03.1999, e cila ka rezultuar e nënshkruar nga shitësi Sinan Gjoni.

4. Me vendimin nr. 204, datë 15.05.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit të kundërpaditur Sinan Gjoni, si të pambështetur në prova dhe në ligj, si dhe pranimin e kundërpadisë të të paditurit/kundërpaditës Xh.Gj; detyrimin e paditësit Sinan Gjoni të njohë si pronar Xh.Gj në pasurinë nr.8/5, për sa i përket sipërfaqes 2700 m<sup>2</sup> në ZK 1299 Budull-Krujë, si pronë të fituar me parashkrim fitues; fshirjen e pasurisë nr.8/5 nga kartela e pasurive dhe hartës treguese nga emri i paditësit, sipas aktit të ekspertimit teknik, si dhe regjistrimin e kësaj prone në pronësi të të paditurit Xh.Gj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kundërpadisë.

5. Me vendimin nr. 1464, datë 11.06.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se ajo gjykatë ka zhvilluar një proces të rregullt gjyqësor, si dhe ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Me vendimin nr. 00-2024-1051, datë 19.03.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) dhe se në të nuk identifikohet asnjë shkak lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material dhe as shkelje të natyrës procedurale në vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta dhe se vendimet e gjykatave nuk bien ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Civil ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

7. Me kërkesën e datës 04.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ndaj tij nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar në asnjë moment për një nga elementet thelbësore të fitimit të pronësisë me anë të parashkrimit fitues me titull dhe se ato duhet të kishin analizuar më hollësisht ekzistencën e mirëbesimit ose keqbesimit në posedimin e sendit nga Xh.Gj. Gjykatat kanë anashkaluar faktin se nënshkrimi i dëshmitarit M.Gj. në deklaratën me shkrim dore të datës 06.01.1999 nuk është i tij, fakt ky i deklaruar prej vetë atij dhe i pretenduar nga kërkuesi gjatë gjykimit. Ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat, posedimi i pronës nga Xh.Gj. nuk ka qenë në mirëbesim, por në keqbesim dhe për këtë shkak afatet e posedimit janë 20 vjet dhe jo 10 vjet. Gjykata e rrethit dhe ajo e apelit kanë bërë një paraqitje selektive dhe të pavërtetë të fakteve dhe rrethanave të çështjes, duke shtrembëruar arsyetimin e vendimit, si dhe nuk kanë përmbushur detyrimin për të zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm gjyqësor. Mungesa e saktësisë në paraqitjen e fakteve passjell cenimin e së drejtës për një vendim të arsyetuar. Gjykata e Lartë kur vendos të shqyrtojë çështjen në dhomën e këshillimit ka detyrimin të arsyetojë se përse nuk e shqyrton atë në seancë gjyqësore.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person

fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në rastin konkret, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë, ndërkohë që për vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar se ankimi kushtetues individual duhet të paraqitet në Gjykatë brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata, si rregull, e llogarit afatin ligjor 4-mujor nga data e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës. Kur bëhet fjalë për vendime të Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij në rastin kur palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 04.09.2024, ndërkohë që vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 19.03.2024. Kërkuesi ka paraqitur bashkëlidhur edhe shkresën nr. 3990/1 prot., datë 03.09.2024 të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës vendimi i asaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët në datën 07.05.2024. Në këto kushte, duke konsideruar këtë të fundit si datën e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e kundërshtuar, pra datën nga e cila fillon të ecë afati ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues ndaj do të shqyrtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

15. Sipas kërkuesit, gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar në asnjë moment për një nga elementet thelbësore të fitimit të pronësisë me anë të parashkrimit fitues me titull dhe se ato duhet të kishin analizuar më hollësisht ekzistencën e mirëbesimit ose keqbesimit në posedimin e sendit nga Xh.Gj. Gjykatat kanë anashkaluar faktin se nënshkrimi i dëshmitarit M.Gj në deklaratën me shkrim dore të datës 06.01.1999 nuk është i tij, fakt ky i deklaruar prej vetë atij dhe i pretenduar nga kërkuesi gjatë gjykimit. Gjykata e rrethit dhe ajo e apelit kanë bërë një paraqitje selektive dhe të pavërtetë të fakteve dhe rrethanave të çështjes, duke shtrembëruar arsyetimin e vendimit, si dhe nuk kanë përmbushur detyrimin për të zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm gjyqësor. Mungesa e saktësisë në paraqitjen e fakteve passjell cenimin e së drejtës për një vendim të arsyetuar. Gjykata e Lartë kur vendos të shqyrtojë çështjen në dhomën e këshillimit ka detyrimin të arsyetojë se përse nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë plenare.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 21, datë 26.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre, nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë, e vënë në lëvizje mbi padinë e kërkuarit, ka vendosur rrëzimin e padisë së tij, si të pambështetur në prova dhe në ligj, duke arsyetuar, në thelb, se nuk është arritur të provohet gjatë gjykimit se të paditurit ishin posedues të pronës, aq më tepër me keqbesim dhe se në rastin konkret përmbushen kushtet për të fituar pronësinë mbi një send të paluajtshëm, sipas nenit 168 të Kodit Civil. Mbi bazën e ankimit të kërkuarit, gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar një proces të rregullt gjyqësor e ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes, duke i gjetur pretendimet e ngritura në ankim të pabazuara. Mbi bazën e rekursit të kërkuarit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se rekursi i paraqitur nga kërkuari nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së dhe se pretendimet e ngritura në të kanë marrë përgjigje nga gjykatat faktit, vendimet e të cilave nuk bien ndesh me praktikën e asaj gjykate, si dhe nuk parashtrohet asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale.

18. Kolegji, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, në këndvështrim të rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim, vëren se vendimet gjyqësore të gjykatave të faktit pasqyrojnë rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe dispozitat ligjore në të cilat janë bazuar për zgjidhjen e çështjes së kërkuarit. Ato kanë vlerësuar provat dhe pretendimet e palëve, përfshirë edhe të kërkuarit, dhe në analizë të tyre dhe të ligjit të zbatueshëm kanë dhënë edhe arsyet mbi bazën e të cilave kanë arritur në përfundimin e shprehur në dispozitiv.

19. Edhe vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në recurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe arsyetimit të kufizuar në lidhje me to, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuari është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore.

20. Nga ana tjetër, për sa u përket pretendimeve të kërkuarit që kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, ato nuk mund të bëhen objekt i këtij kontrolli kushtetues, për sa kohë ai nuk ka argumentuar se zbatimi i ligjit nga ato gjykata ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vetëm fakti

se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkuarit, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

21. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit, Kolegji vëren se referuar parashikimeve të dispozitave procedurale që rregullojnë procedurën e gjyimit në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 482 të KPC-së, shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit bëhet mbi bazë të dokumenteve, kurse neni 482/a i po këtij kodi ka përcaktuar rastet kur gjykata vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe procedurën që ndiqet në një rast të tillë. Gjykata vë në dukje se kjo mënyrë e zhvillimit të seancës gjyqësore, mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk kanë pasur mundësi të debatojnë, përkundrazi, debati realizohet njësoj, pavarësisht formës së paraqitjes me shkrim të argumenteve përmes rekursit, kundërrekursit dhe shpjegimeve (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj, si dhe dispozitat procedurale për shqyrtimin e rekursit dhe njoftimin e palëve, vetëm fakti që ky gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit, nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

22. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriteret paraprake, për rrjedhojë nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.